



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-11635/25 datë:19.05.2025



Npi – 01/202 datë: 27.05.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 27.05.2025 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 27.05.2025 (e martë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtorët – z.Besnik Ahmeti, DBF: Asistentja e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët për Informim znj.Vlora Hyseni, dhe Albion Shabani.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 30.04.2025,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Për diskutim publik)
3. Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Pajtohem me pikat e rendit të ditës. Kadriun e përshëndes dhe e falënderoj për bashkëpunimin dhe punën 4 vjeqare në KPF.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht, miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 30.04.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 30.04.2025.**

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, fjalën ja jap drejtorit Besnik Ahmetit për prezantimin e kësaj pike.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. KAB-in e kemi pranuar tash së fundi me vonesë dhe ne si staf kemi punuar maksimalisht që ta përgatisim materialin për këtë mbledhje të Kuvendit, prandaj edhe ka ardhur edhe te ju pak me vonesë. Meqenëse materialin e keni pranuar unë do të përpiqem që ta prezantoj në pikat Kryesore. Komuna e Shtimes për vitin 2026 planifikon të ketë një Buxhet prej 11,443,986.00 euro nga të gjitha grantet të shpërndarë nëpër kategori ekonomike, të cilat

në vazhdim i lexoi. (Shih dokumentin). Ky pra është një Draft i cili duhet të shkojë në diskutim publik dhe mund të ndryshohet varësisht nga prioritetet dhe kërkesat që vijnë e që janë të arsyeshme. Kemi një kërkesë nga Ministria që të planifikojmë një rritje të pagave të DKA-ja. Në vazhdim ju ftoj që ta miratoni vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik KAB-in 2026-28. Nëse ka ndonjë pyetje jamë i gatshëm të përgjigjem.

z.Kadri Emini: Faleminderit, rritja e pagave u tha që ka me u kompensuar në vitin 2026, a po na sqaron pak më shumë për këtë?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Buxheti është rritë rreth 655 mijë euro. (Në vazhdim drejtori lexoi dhe komentoi disa të dhëna me shifra konkrete).

z.Përparim Ramusa: Ne si subjekt i PDK-së e përkrahim që të shkojë në diskutim publik. Na gëzon fakti që për vitin 2026 do të kemi rritje të Buxhetit të Komunës afër 700 mijë euro. Po ashtu na gëzon fakti që do të ketë rritje të pagave.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Rritje ka me ndodhë prap në vitin 2026 ku koeficienti nga 110 do të shkojë në 115, a është planifikuar se kah do të mbulohen, sepse unë mendoj se buxheti është dashur të jetë mbi 12 milion euro.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Siq e dini për ndarjen e Buxhetit janë disa kritere siç janë numri i banorëve, pozita gjeografike, etj. Nëse ka rritje të pagave, atëherë Qeveria e Republikës së Kosovës e ka për obligim me i mbulu.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Veç sa për me sqaruar më mirë, me qëllim që me ja lidhë kryet mirë kësaj pune me Ministrinë, sepse unë mendoj që me të drejtë e ngriti Kadriu çështjen e ngritjes së pagave. Kjo duhet me u definu mirë dhe qartë sepse nuk ka mundësi që pastaj të merren mjete nga kodet tjera buxhetore.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit, vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028.**

Pika 3

Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027. (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Propozoj që sqarimet për këtë pike të ipen në Kuvend.

z.Përparim Ramusa: Pajtohem me propozimin e Kryesuesit që sqarimet për këtë pike të na ipen në mbledhjen e Kuvendit më 29.05.2025.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Planit të punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027. Me kërkesën që në mbledhjen e Kuvendit më 29.05.2025 të prezantohen diskutimet, ose propozimet që kanë dalë nga diskutimi publik me qytetarë.**

z.Kadri Emini: Unë dua të ju falënderoj të gjithëve në Komitetin për Politikë dhe Financa për punën dhe bashkëpunimin që e kemi bërë bashkarisht. Unë nuk do të jem më anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa për arsye personale dhe angazhimeve të mia që i kamë. Edhe një her faleminderit dhe ju uroj punë të mbarë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime të tjera nuk ka, mbledhjen e përfundoj në ora 10:47h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

